



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 25.04.2023

PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA  
KUKËS, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.8, DATË 08.02.2017  
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.8, datë 08.02.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kukës”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kukës, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.21 datë 14.04.2023, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Kukës, të miratuar me Vendimin Nr.8, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
  - *Rregullores së Planit:*
    - Shënimet për lartësitë maksimale në kate dhe në metra, ndryshohen;
    - Në nenin 11 “*Sistemi Rezidencial (A)*”, pas pikës 2 shtohet pika 3;
    - Në nenin 24 “*Industri e lehtë (IE.1)*”, ndryshon pika 2 dhe gërmat “a”, “e” dhe “f” të pikës 5;
    - Në nenin 30 “*Shërbime tregtare (S.13)*”, ndryshon gërma “e” e pikës 5;
    - Në nenin 63, “*Brezat kufizues për ndërtimet (Distanca nga rrugët dhe hekurudha)*”, ndryshon nënpika VI e pikës 2;
    - Pas nenit 63 “*Brezat kufizues për ndërtimet (Distanca nga rrugët dhe hekurudha)*”, shtohet neni 63/1 “*Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C*”;
    - Neni 68 “*Përcaktimi i zonave mbrojtëse përgjatë baseneve ujore (vija blu)*”, ndryshon”;
    - Pas nenit 68, “*Përcaktimi i zonave mbrojtëse përgjatë baseneve ujore (vija blu)*”, shtohet neni 68/1 “*Burimet e ujrave*” dhe neni 68/2 “*Kanalet vaditëse/Emisaret*”;



- Pas nenit 69 “Rregullat arkitektonike dhe estetike”, shtohet neni 69/1 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”;
  - Pas nenit 70 “Përcaktimi i instrumenteve të aplikueshëm për drejtimin e zhvillimit dhe zbatimin e PDV-ve”, shtohet neni 70/1 “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm” dhe neni 70/2 “Kushte për objektet ekzistuese në sistemin bujqësor dhe natyror”;
  - Në nenin 73 “Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse”, pas pikës 6, shtohen pikat 7, 8 dhe 9;
  - Në nenin 84 “Tabelat përmbledhëse e të dhënave kryesore për të gjitha njësitë” ndryshohen përcaktimet sipas ndryshimeve në nenet 24 dhe 30, të paraqitura në Kreun I të Dokumentin e Rishikimit të PPV, Bashkia Kukës.
- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Kukës, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Kukës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Kukës, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOFA

